



**Organizata jo-qeveritare Emancipimi Civil Ma Ndryshe
EC MA ND RYSHE**

1 tetor 2018, Prizren

**KOMUNIKATË
Prizreni, një qytet i të drejtave të njeriut**

EC ka mbajtur konferencën përmbyllëse të projektit “Rikthimi i qytetit - E Drejta mbi Qytetin për grupet e nënpërfaqësuar të komunitetit në Prizren”. Gjatë konferencës “Prizreni, një qytet i të drejtave të njeriut” janë shpalosur objektivat dhe të arriturat e projektit në fjalë si dhe është diskutuar publikimi i Kartës së Qytetit “E Drejta mbi Qytetin e Prizrenit”.

Projekti “Rikthimi i Qytetit” është një përpjekje për të mbështetur grupet e nënpërfaqësuar të komunitetit që të gëzojnë plotësisht të drejtën mbi qytetin përmes një sërë aktiviteteve dhe platformash mobilizimi të komunitetit. Duke pasur për qëllim që nëpërmjet aktivizmit të nxisë reforma demokratike të planifikimit urban në Prizren, në kuadër të projektit janë realizuar një sërë prezantimesh në shkolla të mesme dhe univeristete, takime të vazhdueshme me grupet e nënpërfaqësuar të komunitetit lidhur me nismën e qytetarëve për Kartën e Qytetit, punëtori vizionuese për rikthimin e hapësirave publike, gara e videove me telefona të mençur për të rinjtë si dhe Shkolla e Aktivizmit Urban për studentë si dhe nxënës.

Në fokus të konferencës përmbyllëse “Prizreni, një qytet i të drejtave të njeriut” ishte prezentimi i Kartës së Qytetit “E drejta mbi qytetin e Prizrenit”, dokument ky që ka për qëllim që të promovojë dhe fuqizojë të drejtat e njeriut për të gjithë qytetarët e Komunës së Prizrenit, në kuadër të menaxhimit të përgjithshëm të qytetit. Paneli i përbërë nga Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Artan Abrashi dhe autori i hulumtimit, Fisnik Minci diskutuan mbi rëndësinë dhe mekanizmat e Kartës së Qytetit.

Propozim Karta e Qytetit të Prizrenit e cila ka marrë përkrahjen e mijëra qytetarëve përmes nënshkrimit të peticionit do t’i prezantohet autoriteteve të pushtetit lokal të Prizrenit, me kërkesën që i njëjti të shqyrtohet dhe miratohet nga organet vendimmarëse komunale dhe më pastaj të zbatohet nga dikasteret e Ekzekutivit lokal.

Projekti “Rikthimi i qytetit- E Drejta mbi Qytetin për grupet e nënpërfaqësuar të komunitetit në Prizren” është një angazhim i EC-it në promovimin e hapësirave publike të sigurt, gjithëpërfshirëse, të qasshme, të gjelbra, të qëndrueshme dhe cilësore në Prizren, duke përfshirë, por pa u kufizuar vetëm në: rrugë, trotuare, korsi çiklizmi, sheshe, zona ujore, kopshte dhe parqe. Ky projekt është mbështetur nga National Endowment for Democracy.

OJQ EC Ma Ndryshe
Rr. Saraçët, Nr. 5 - Prizren
Bulevardi Nënë Tereza, H 30 B1 Nr. 5, Prishtinë
www.ecmandryshe.org & info@ecmandryshe.org
+381 38 224 967 & +381 29 222 771